



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. Org. Unit: SP-02
Nr. i Faqeve Nr. Stranica: -04-
Nr. i Dyt. Prof. Prot. No: 2557-2/23
Data: 09.05.25
Prishtinë / A No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.05.2025
REFERENC-Ë:	23/2557/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	N.T.P. "Rec-Plast" Vitomiricë, Pejë, Qendër për grumbullim dhe riciklim të mbeturinave plastike
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdim të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit N.T.P. "Rec-Plast" Vitomiricë, Pejë, me Nr.Prot.23/2557/MMPHI, për veprimtarinë: Qendër për grumbullim dhe riciklim të mbeturinave plastike.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/2557/MMPHI
Datë: 14.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi, 1, 2 dhe 4 të nenit 12, neni 17, paragrafi 2 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit N.T.P. "Rec-Plast" Vitomiricë, Pejë, i vazhdohet Leja Mjedisore, me nr. prot. 23/2557/MMPHI, për veprimtarinë: Qendër për grumbullim dhe riciklim të mbeturinave plastike, në ngastrat me nr.1773/12 dhe 1773/13, zona kadastrale Vitomiricë, Pejë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të përmbahen kushteve të lejes ujore për shkarkim;

- 2.3. Mbetjet nga procesi teknologjik, të vendosen në hapësirë të betonuar dhe izoluar, ose të vendosen në kontejner të mbyllur;
- 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit te mjedisit;
- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;
- 2.6. Pas përfundimit të funksionimit të fabrikës, operatori është i obliguar ta bëjë rehabilitimin dhe rikultivimin e lokacionit ku ka kryer veprimtarinë.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, fakteve të grumbulluara dhe verifikuara në teren, është konstatuar se operatori N.T.P. "Rec-Plast" Vitomiricë, Pejë, **i plotëson kushtet për vazhdimin e Lejes Mjedisore**, sipas kërkesës me nr. prot. 23/2557/MMPHI, për veprimtarinë: Qendër për grumbullim dhe riciklim të mbeturinave plastike, në ngastrat me nr.1773/12 dhe 1773/13, zona kadastrale Vitomiricë, Pejë.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.08/2561/3-ZSP-352/10, të lëshuar me datë: 06.09.2010;
- Leje Mjedisore, nr.15/4893/ZSP/155/16, të lëshuar me datë: 07.11.2019;
- Leje Ujore për shfrytëzim, nr.7928-3/22-ZSP-2023, të lëshuar me datë: 31.03.2023;
- Leje ujore për shkarkim, nr.7929-3/22-ZSP-2023, të lëshuar me datë: 31.03.2023;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore dhe merr **Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore**.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.



Izedin Bytyqi

U.D. / Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Pejë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së